



ISO = POLIFONIA

PRILL 2006, NR. 4

Botimi i Këshillit të Muzikës Shqiptare dhe Seksionit Shqiptar të CIOFF-it
Realizuar në bashkëpunim me stafin e gazetës "Dita JUG"

Kryeqyteti i polifonisë promovon "kryeveprën botërore"

Organizohet në Vlorë Festa e Polifonisë me logon "Faleminderit UNESCO"

Nga Istref Dobi

Më datë 19.04.2006, në Teatrin "Petro Marko" në qytetin e Vlorës u organizua veprimtaria "Faleminderit UNESCO, Në Festën e Polifonisë". Veprimtaria u organizua nga Qendra Kulturore e qytetit në bashkëpunim me Shoqatën "Labëria". Kjo veprimtari u zhvillua në kuadrin e zbatimit të Udhëzimit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, nr. 1, datë 09.12.2005 "Për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e Iso-Polifonisë Shqiptare" pas njohjes së Iso-Polifonisë nga UNESCO si "Kryevepër të trashëgimisë gojore të njerëzimit".

Veprimtarinë e hapi z. Sejmen Gjokoli, kryetari i Shoqatës "Labëria", më pas z. Gëzim Halili lexoi përshëndetjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pastaj folën z. Vasil S.Tole, z. Muhamet Tartari, z. Istref Dobi dhe në fund z. Shpëtim Gjika. Kryetari i Bashkisë së Vlorës pasi falenderoi MTKRS dhe UNESCO-n për vlerësimin që i bënte Iso-Polifonisë Shqiptare shpalli se kjo veprimtari i paraprind veprimtarisë së madhe shkencore që do të zhvillohet nga MTKRS në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit në fund të muajit maj, Simpoziumin Ndërkombëtar për Iso-Polifoninë Shqiptare.

Në të gjitha diskutimet u falenderuar në mënyrë të veçantë Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për kontributin e dhënë në njohjen e Iso-Polifonisë nga UNESCO, si "Kryevepër të trashëgimisë gojore të njerëzimit", u nxorën në pah vlerat unike të iso-polifonisë dhe u

shpreh dëshira për të shtuar veprimtaritë e këtij lloji. Kjo veprimtari organizuar nga Qendra Kulturore e qytetit të Vlorës në bashkëpunim me shoqatën kulturore atdhetare Labëria dega e Vlorës dhe mbështetur nga Bashkia e qytetit të Vlorës gjeti përkrahje dhe pjesëmarrje masive të disa prej këngëtarëve dhe grupeve më të njohura dhe më të spikatura të isopolifonisë: nga Gjirokastra, Tepelena, Delvina, Mallakastër, Vranishti, Tërbaci, Smokthina, Dukati, Vezhdanishti, Lapardha, Kanina, Armini, Bregdeti, etj. Ndërmjet diskutimeve grupe polifonike nga Gjirokastra, Vranishti, Kanina, Bregdeti, Tepelena, Lapardhaja, Vezhdanishti interpretuan këngë nga zonat e tyre. Kjo veprimtari u ndoq me shumë interes nga publiku vlonjat dhe u pasqyrua në mediat televizive të Vlorës dhe Fierit.



Në foto: Grupet polifonike, pjesëmarrëse në Festën e Polifonisë "Faleminderit Unesco", mbajtur në Vlorë.

Festival "i vogël" që ushqen Festivalin e madh shqiptar Përfundon në Gjirokastrë edicioni i katërt i Festivalit Kombëtar të Veglave të Muzikës Popullore

Edicioni i katërt i Festivalit Kombëtar i Veglave të Muzikës Popullore Gjirokastra 2006, i mbajtur nga data 17 deri në 19 maj, tregoi edhe një herë se ky aktivitet është bërë pjesë e rëndësishme e kalendarit të ngjarjeve më të rëndësishme kulturore të vendit. Ai ka ndikim të dukshëm në ruajtjen dhe përcimin e trashëgimisë shpirtërore të popullit tonë në brezat e rinj. Organizimi i kësaj veprimtarie kombëtare, me shtrirje të gjerë gjeografike dhe me kritere të përcaktuara mirë, i mësoi lidhjes së fu-

qishme që egziston mes Iso-Polifonisë dhe traditës së shoqërimin të saj me veglat popullore.

Ndër vlerat më të spikatura të këtij festivali, ekspertët e folklorit dhe etnomuzikës të pranishëm në të, përmenden pjekurinë dhe nivelin e lartë interpretativ të artistëve popullorë, larminë e repertorit, shumëllojshmëria e veglave muzikore të traditës, harmonizimin e tyre me Iso-Polifoninë dhe këngë të llojeve të tjera. Gjetja dhe prezantimi i instrumentave të vjetër muzikorë frymore, evidentimi i folklorit autentik dhe koncept-

timi i shfaqjeve konkurruese si spektakle të vërteta u mirëpritën nga publiku.

Në natën e tretë përshëndetën festivalin këngëtarja Irini Qirjako, fituese e dy çmimeve, "Mjeshtre e madhe e punës", si dhe grupet e njohura të Iso-Polifonisë "Zëri i Bilbilit" nga Saranda dhe grupi i të rinjve të Gjirokastrës "Ergjëria".

Meritë për organizimin e këtij festivali ka Kryetari i këshillit të qarkut Resul Llogo dhe bashkorganizatorët e tjerë: MTKRS, bashkia e Gjirokastrës, bashkia e Tepelenës, bashkia e Përmetit, Qendra Ko-



mbëtare e Organizimit të Veprimtarive Folklorike, Instituti i Kulturës Popullore dhe Qendra Rajonale e Studimit dhe Trainimit të Mediave.

Në fund të këtij eventimi të shoqëruar me veprimtari të shumta si

promovime librash, tryeza diskutimesh, shfaqje filmsh, etj, juria vlerëso me çmimi të parë Qarkun e Lezhës, me motivacion: "Për larminë e instrumentave (20) të sjella në programin e konkurimit".

G.Brahimi

STAFI I GAZETËS
ISO-POLIFONIA

"Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony"

"Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit"

"A Masterpiece of oral and intangible heritage of humanity"

Organ i përmuajshëm i Këshillit të Muzikës Shqiptare, anëtar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës IMC/UNESCO dhe seksionit Shqiptar të CIOFF-it. Gazeta botohet në qytetin muze të Gjirokastrës, "Pasuri kulturore e njerëzimit" mbrojtur nga UNESCO.

KËSHILLI BOTUES

KRYETAR NDERI: Prof. Ramadan Sokoll

KRYETAR I KËSHILLIT BOTUES:

Prof. Dr. Vasil S. TOLE.

ANTARË:

Akademik Jorgo Bulo, Prof. Dr. Fatmir Hysli, Prof. Agron Xhagolli, Prof. Spiro Shituni (USA), Dr. Eno Koço (Angli), Prof. As. Josif Minga, Bardhyl Londo, Aleks Todhe.

DREJTOR: Niko Mihal.

KRYEREDAKTOR: Engjëll Serjani.

KOLEGJIUMI I REDAKSISË:

Arian Avrazi, Ilir Dhuri, Lefter Cipa, Muhamet Tartari, Sejmen Gjokoll, Maksi Kulo, Thanas Dino, Shkëlqim Hajno, Shkëlqim Guçe. Prgatitë materialet në anglisht: Gentiana Brahim.

Art-Design: Klidi Proko.

Kontakt: Këshilli i Muzikës Shqiptare

e-mail: tole@isopolifonia.com

Mob: 0 68 21 55551

Seksioni shqiptar i Cioff-it:

E-mail: egjikassoc@albmail.com

Cel: 0 69 22 34986

Gazeta "Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony":

E-mail: ditajug@yahoo.com

Cel: 068 22 04502



Këshilli i Muzikës Shqiptare-KMSH është person juridik i regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me nr. Akti 3074, me vendimin nr. 1784. K.M.SH-Albanian Music Council zyrtarisht njihet si Komiteti Nacional i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës (IMC)-UNESCO, në Shqipëri. (CIM/49.631).

Ministri Leskaj: Polifonia dhe folklori prioriteti ynë afatgjatë



Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Bujar Leskaj.

Në festën e Iso-polifonisë në Vlorë erdhi dhe u mirëprit nga artistët popullorë të ardhur nga trevat e polifonisë dhe të pranishmit në sallë edhe përshëndejta e Ministrit TKRS Bujar Leskaj "Të nderuar artistë pjesmarës në Festën e Polifonisë që zhvillohet sot në, qytetin e Vlorës, në kryeqyte-



tin e polifonisë shqiptare. Të nderuar spektatorë art-dashës të qytetit të Vlorës, jam shumë i nderuar që, si Ministër i Turizmit, Kul-

turës, Rinisë dhe Sporteve, të përshëndes këtë veprimtari të rëndësishme që i dedikohet një vlerë të pamohueshme të

trashëgimisë shpirtërore të popullit tonë, polifonisë sonë". Sikurse dihet, azhdon përshëndetja, më datë 25 nëntor 2005, Juria Ndërkombëtare e UNESCO-s, shpalli polifoninë shqiptare "Kryevepër të trashëgimisë gojore të njerëzimit", duke e bërë atë tashmë të njohur botërisht, dhe duke na venë të gjithëve, si pushtetit qëndror e vendor dhe artistëve që levrojnë këtë gjini, përpara detyrave të rëndësishme për ruajtjen, mbrojtjen, promovimin dhe popullarizimin e saj.

"Jo më kot qytetit i Vlorës është quajtur kryeqyteti i polifonisë shqiptare për nga vlerat që ajo ka trashëguar, për veprimtaritë e shumta që zhvillohen këtu por edhe për përkushtimin që tregohet për të nga drejtuesit e pushtetit vendor dhe të Qendrës Kulturore të këtij qyteti", thekson te Leskaj në këtë përshëndetje.

Ministri u përcollti një përshëndetje të gjithë artistët popullorë që me punën e tyre të palodhur kanë kontribuar për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë shpirtërore shqiptare. "Në emër të Qeverisë Shqiptare dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, deklaroj para jush se trashëgimia kulturore e në mënyrë të veçantë folklori ynë i mrekullueshëm do të jenë një prioritet afatgjatë i punës sonë", nënvizoi Leskaj në përshëndetjen e tij.

Istref Dobi
Korespondenti i gazetës
"ISO POLIFONIA"
Vlorë, 19 Prill, 2006

Opinione të folkloristëve dhe etnomuzikologëve për Festivalin e Veglave

Prof. Dr. Vasil S. Tole, Drejtori i Trashëgimisë Kulturore në MTKRS

Lidhur me suksesin e këtij edicioni folklorik dhe rëndësinë e tij, drejtori Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore në MTKRS, Prof. Dr. Vasil S. Tole thotë se ai është një festival që mban të pafikur "pishtarin" e fokut shqiptar sepse është një festival i përvitshëm. "Festivali Kombëtar i Veglave të Muzikës Popullore edhe kësaj here e realizoi qëllimin e tij, qëllim që lidhet me mbajtjen ndezur të atmosferës folklorike dhe të trajtimit të një tematike të pjesëshme për Festivalin Folklorik Kombëtar".

Dhe vërtetë, thotë Tole, këto festivale, të ashtuquajtur "të vegjël", sikurse janë edhe Oda Dibrane, Iso-Polifonia në Vlorë, kënga qytetare në Elbasan, Sharrë Këndon, Përmeti Multikulturor, festivali i sazeve në Korçë, festivali i rapsodëve lahutarë në Veri, etj, janë si "përrenj" të vërtetë dhe të rrëmbyshëm që ushqejnë festivalin tonë të madh që zhvillohet një herë në katër vjet këtu në kalanë e Gjirokastrës.

Prof. Dr. Afërdita Onuzi Drejtore e Institutit të Kulturës Popullore

Qëllimi për të cilin organizohet ky festival është që të shërbejë si tematikë për Festivalin Folklorik Kombëtar. Nga sa kam ndjekur këto dy ditë them se festivali edhe kësaj radhe e realizoi qëllimin e tij. Këto festivale na japin materiale për të përzgjedhur për ngjarjen më të rëndësishme të folklorit që është Festivali Kombëtar që mbahet po në Gjirokastrë. Këtu prezantohen instrumenta dhe instrumentistë, më të mirët e të cilëve fitojnë statusin të prezantohen në një stad më të lartë.

Për realizimin e këtij festivali dua të falenderoj në mënyrë të veçantë Kryetarin e Këshillit të Qarkut Resul Llogo. Ai ka një meritë të madhe pasi i vetëm ka mundur të realizojë mbajtjen e këtij festivali të tillë dhe ka zgjidhur shumë probleme për mbarëvajtjen e tij. Më vjen mirë gjithashtu që shumë aktivitete dhe veprimtari të tjera po shoqërojnë këtë festival që shërben për të mbajtur gjallë trashëgiminë kulturore të kombit shqiptar.

Prof. Dr. Agron Xhakolli, folklorist

Kur flasim për folklor asnjëherë nuk duhet kërkuar ndonjë gjë e re. Folklori jeton dhe përcillet në variante. Ai jeton përmes varianteve të reja në interpretim dhe egzekutim. Ç'farë ka të re, mënyra si transferohet dhe si përcillet nga brezat, sa dhe si ruhet. Duke ardhur nga interpretues e grupe të ndryshme sigurisht që ajo ç'ka përcillet sjell larmi e risi duke e bërë folklorin të jetojë e të kalojë në breza. Në këtë kuptim festivali i veglave të muzikës popullore është një veprimtari kombëtare me vlera për ruajtjen e folklorit sepse sjell risitë e veta që kanë të bëjnë me shumëllojshmërinë e varianteve interpretuese, sjell interpretues të rinj. Kur flasim për risi duhet të pranojmë se edhe një këngë apo melodi e njohur e traditës folklorike, kur interpretohet nga një këngëtar apo instrumentist pa asnjë dyshim që sjell element të rinj të individualitetit të këtyre bartësve. Si folklorist pjesa më e madhe e këtyre interpretimeve që vijnë në këtë skenë për mua janë të njohura, të njohur janë edhe disa nga artistët që kanë marrë pjesë në festivalet folklorike, por si njohës i kësaj fushe mund të them se në interpretimet e reja të pjesve të vjetra kanë gjithmonë vlera të reja dhe interesante.

Prof. Dr. Josif Minga, etnomuzikolog

Parada e vlerave folklorike të këtij vitit tregoi edhe një herë se gura popullore nuk shpërtheu. Artistë dhe instrumentistë nga shuma treva të vendit përcollën emocione me interpretimet e tyre. Larmi në instrumenta dhe në mënyrë interpretimi, duke sjellë prurje të reja. Shumë prej konkuresve kishin përzgjedhur motive burimore dhe vegla të hershme. Këto festivale shërbejnë edhe për të transmetuar folklorin në breza. Unë i ndjek gjithmonë me dashuri e vëmendje evenimetet e tilla dhe dua të falenderoj gjithë organizatorët që bëjnë të mundur festivale të tilla. Ndihem i nderuar që isha pjesë e jurisë së këtij festivali dhe mund të jem i pranishëm në të. Meloditë, veglat e motivet janë të njohura, por përmes egzekutimeve në skenë gjithmonë sillt diçka e re me vlerë që pasuron folklorin.

Polifonia, zonja e parë e kulturës shqiptare



Festa e Iso-polifonisë, festa me e re për fenomenin më të vjetër muzikor të njerëzimit

Nga Sejmen Gjokoli*

Në Vlorë u organizua për herë të parë Festa e Iso-polifonisë, padyshim kjo është festa me e re për fenomenin më të vjetër muzikor të njerëzimit dhe Vlorë që mori këtë iniciativë është në nderin e saj sepse Vlorë ka qënë dhe mbetet kryeqytetit i vërtetë i polifonisë shqiptare. Nuk ka fshat në zonën që që këndohet polifonisa në rrethin e Vlorës që të mos ketë grupin e tij polifonik, që të mos ketë rapsodin e tij që i grumbullon këngët e traditës së fshatit dhe që bën edhe këngë të reja për të ushqyer grupin polifonik, nuk ka festival kombëtar folklorik që grupet e Vlorës të mos sjellin perla të vërteta të polifonisë. Prej pesë vitesh në qytetin e Vlorës, nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve organizohet çdo vit Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonisë, ku janë mishëruar vlerat më të mira të kësaj pasurie të folklorit tonë, duke ndikuar edhe në kalimin e saj në brezat e rinj dhe promovimit dhe ballafaqimit të vlerat kulturore në gjininë e polifonisë.

Duke parë aktualisht një interes më të madh nga bota kulturore për iso-polifoninë tonë, shpresojmë shumë edhe në rritjen e vëmendjes së qeverisë për ruajtjen e kësaj vlerë të trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe vënien e saj në funksion të turizmit kulturor, sepse kështu do të rritet cilësia dhe financimet për këto veprimtari që mund të sjellë një turizëm kombëtarë, mbarëkombëtar dhe ndërkombëtar për të njohur nga afër këto vlera të kulturës tonë kombëtare tashmë të përfillura e të pranuar nga bota. Kjo veprimtari që u organizua së fundi në Vlorë për promovimin dhe popullarizimin e këtyre vlerave të pamohueshme që tashmë janë pjesë e "Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit", do të ndihmojë më shumë në rritjen e përkujdesjet për mbrojtjen dhe promovimin e kësaj gjinie të folklorit tonë të pasur

Në emër të Shoqatës "Labëria" unë do të falenderoj më së mirë të veçantë korifejtë dhe këngëtarëve të shquar të polifonisë, ata artistë që përfaqësojnë plot hir dhe madhësi gjithë bartësit dhe interpretuesit e polifonisë shqiptare. Të mbledhur së bashku me këta njerëz të këngës në sofrën e polifonisë, të kësaj "zonje" të rëndë e të e cila prej 25 tetorit 2005, u pranua nga UNESCO si një nga kryeveprat e trashëgimisë gojore të njerëzimit, nuk ka si të mos ngazëllëhesh. Emocioni është i natyrshëm pasi "e dashura" jonë polifoni, është certifikuar kështu nga një prej institucioneve kulturore më prestigjioze të Europës. Ky akt i madh ndodh në këtë kohë që Europa ëndrra jonë e madhe ka përshpejtuar integrimin tonë. Me këtë akt ajo na ka vënë të gjithëve në një borxh të madh: ta ruajmë e ta përcjellim iso-



Në foto: Një prej grupeve polifonike, pjesëmarrëse në Festën e Polifonisë "Faleminderit Unesco", mbajtur në Vlorë.

polifoninë në brezat që do të vijnë si një gjë e çmuar, si një visaret tona kombëtare. Ndaj edhe në veprimtarinë "Faleminderit UNESCO" unë personalisht formulova dy falenderime zemre dhe thirra me plot gojë: Faleminderit UNESCO për nderin që na bëre! Faleminderit dhe ty populli im për thesarin e madh që krijove dhe trashëgove në shekuj!

Por meqënëse jemi tek falenderimet, besoj se natyrshëm kjo fjalë u takon edhe atyre që përgatiten e sh-

truan "sofrën" dhe "hyzmexhinjë" që realizuan këtë gosti të madhe: Ministrisë sonë të Kulturës dhe strukturat e tjera brenda dhe jashtë vendit, përfshi dhe Zyrën e UNESCO-s për Shqipërinë në Tiranë. Një falenderim i veçantë edhe për Prof. Dr. Vasil Tolen, këtë mik të madh të polifonisë mbarë shqiptare, i cili nga pozicioni i nderuar i drejtuesit të Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore që di ti jap udhë me profesionalizëm dhe këmbëngulje procesit të pranimit të

isopolifonisë në kancelaritë europiane. Padyshim mirënjohja më e thellë i përket të gjithë atyre brezave që në shekuj e mbajtën këngën gjallë dhe me zërin e tyre mbetën në memorien e gjenit popull. Nderim dhe mirënjohje për Neço Mukon, Dhimitër Varfin, Xhevat Avdallin, Demir Zykon, Alush Milorin, Dervish Gumën, Beqir Laçen, Petrit Matushin e shumë e shumë të tjerëve, të vdekur e të gjallë, yje polifonie, qëndisur në panteonin e këngës së popullit. Dua të besoj se

vlerësimi i lartë që tanimë Europa i ka akorduar polifonisë shqiptare përbën njëherësh edhe një detyrim madhor e njerëzor për të gjithë bartësit, krijuesit dhe interpretuesit e këngës polifonike. Tani kemi për detyrë të punojmë e kontribuojmë edhe më shumë në ruajtjen dhe transmetimin e vlerave tona shpirtërore për ta mbajtur e merituar këtë nder dhe krenari që na fali polifonia jonë, kjo kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit.

Do të dëshiroja që të bëja edhe një konstatim domethënës për këtë festë të re që "pagëzuan" në Vlorë, sepse ajo është festa me e re për këtë fenomen që padyshim është ndër më të vjetrit fenomen muzikor dhe kulturor i njerëzimit që është transmetuar me dashuri e fanatizëm nga brezi në brez qysh prej lashtësisë. Nëse është kështu, atëherë le ta ruajmë si sytë e ballit dhe t'a zhvillojmë më tej këtë Zonjë të Parë të trashëgimisë kulturore autentike shqiptare.

* Kryetari i Shoqatës "Labëria" Vlorë

Në emër të atyre që shpirti u pikon mbi penë

Kush e shpiku këngën/goftë i paharruar/kush e mban të gjallë/vdektë duke kënduar...

Nga Muhamet Tartari*

Festa e polifonisë labe është festa me e re për mënyrën më të vjetër të kënduarit nga njeriu. Është padyshim një eveniment i veçantë, pasi nuk ka pasur, nuk ka dhe nuk do të ketë festë, dasëm e gëzim në Vlorë e Labëri pa polifoni. Në këtë kontekst ajo mbetet Festë e Festave dhe për këtë pa hezitim duhet të themi Faleminderit UNESCO, për nderimin dhe vlerësimin e polifonisë labe, të polifonisë shqiptare, të shpirtit të paepur të zemrës së ndezur, të një populli vital, të një kombi vigan. Kisha nderin e veçantë dhe kënaqësinë e madhe të përshëndesja në atë takim - festë - polifoni, në një ditë të bukur prilli, ku ja thosh këngës biblilë, në emër të miqve, shokëve dhe kolegëve të mi të dashur e të nderuar, të atyre që shpirti u pikon mbi penë, në emër të atyre që gatuajnë vargjet burim, që pjekin këngët frymëzim për bilbilat e polifonisë për këngëtarët e mrekullueshëm të Labërisë. Fola atë ditë me fjalë shpirti dhe urime zemre në emër të atyre që dikush na quan rapsod, të tjerë vjershëtarë, disa bejtexhi, kurse unë i përcaktoj poet popullor, pasi në fund të vargjeve, të vjershave të këngëve tona është firma POPULLI. E ky për ne është një vlerësim i lartë është nderim i madh, është respekt e mirënjohje. Unë kam fatin e madh që të jetojë e gëzojë, të krijojë dhe këndojë në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe në vitet e para të shekullit XXI, me krijuesit dhe interpretuesit e shquar të polifonisë labe, pasuri e vyer botërore: shumë zëra në një zë / shumë zëra bërë një / harmoni dhe bukuri / e kanë emrin polifoni... Homazh - nderim - respekt e mirënjohje, për ata që nuk janë fizikisht, por jetojnë mes nesh dhe janë gjallë në vargjet dhe këngët e tyre: Dule Havari i Dukatit të Vlorës, Maliq Lila i Bëncës Tepelenë, Zaho Balili i Rexhin-

*Kush e mbolli këngën labe
Nëpër të shpirtit livadhe
Si sot e mijëra vjet
Nderim paçin përjetë
Pa nota, pa pentagram
Pa violinë, piano, kitarë
Mbi të nëntat sinfoni
Kënga labe mrekulli
Do jetojë polifonia
Sa të rrojë Shqipëria
Me shyaje ngjyra ylberi
UNESCO të faleminderit
Vlorë 19.4.2006*

it e Hormovës, Hamdi Pulua i Tragjasit, Mejd Skëndua i Tërbaçit. Përsëritet - nderime e urime, shëndet e jetë të gjatë / krijimitari të begatë / mendjen dritë e penën shpatë / ...Lufter Çipës së Pilurit e Bregdetit, Kujtim Micit të Tërbaçit, Feti Brahimit të Lapardhas, Petrit Llanaj Gjirokastër, Ner-tesi Asllanit të Bolenës dhe Jehonës Labe, Mynyr Zykes së Vranishtit, Tomorr Lelo dhe dhe Novruz Jahaj Smokthinë, Nexhip Serës së Bratit, Meleq Kapllanit të Kaninës, Hysni Kapos të Dukatit;;; e lista është e gjatë, të më falin që si përmendin dot të gjithë: Kush e shpiku këngën / goftë e paharruar / kush e mban të gjallë / vdektë duke kënduar... Përsëritet dhe falenderim dhe urime për ata virtuozë të ekzekutimit këngëtarë e valltarë, marrësa e ktheysa, hedhësa, pjesëtarë të Isos, që me zërat e tyre brilantë, me zemrën e tyre të artë

bënë eposin e tyre në Polifoni nga Himara e Piluri, në Tepelenë e Gjirokastër, nga Vranishti e Tërbaçi, në Lapardha e Kaninë, nga Dukati e Tragjasi në Vranisht e Armen, nga Delvina në Mallakastër, kudo ku rrjedh polifoni e pastër. Përsëritet - respekt e mirënjohje për ata profesorë që kanë dhënë ndihmesën e tyre dhe për polifoninë: Haxhi Dalipi, Jani Kosta, Guri Gjeçi, Istref Debi në Vlorë, Roland Çene, Naxhi Kasaruho e të tjerë në Gjirokastër, Fatmir Meçe me të tjerë në Tepelenë, kudo ku jetojnë dhe punojnë. Përsëritet - mirënjohje - nderim dhe falenderime për ata që prezantuan dhe u paraqitën aq bukur sa është e bukur, aq madhështore sa është madhështore, aq të përsosur sa është e përsosur Polifonia labe, Profesorin Vasil Tole me ekipin realizues. Po kështu edhe Ministrin vlonjat Bujar Leskaj që me marrjen e këtij posti të rëndësishëm solli lajmin e mirë dhe sihariqin e madh të UNESCO-s. Përsëritet dhe urime për ata krijues dhe interpretues të rinj që do ta çojnë përpara Polifoninë.

* Poet popullor

Polifonia në kontekstin piktoral ekspresiv

Piktori vlonjat Artan Shabani nga Torino krijon një imazh shqiptar me ngjyra polifonike

Nga Arsim Kajtazi

Artist nga natyra, Artan Shabani, talentin e tij e zhvilloi në një piktor me nota të thella polifonike, duke e shfaqur një realitet kompleks, që e bartë nga qenia dhe kujtesa e tij, i mishëruar me ambientin shqiptar, prej të cilit asnjëherë nuk ndahet për të dëshmuar gjenezën. Por, prore të modeluar prej një pikëvrojtimi me intencë moderne, duke krijuar substratin e tij artistik integrale, si kulturë, kualitet sa etnik, etnografik, artistik, po aq edhe universal që të gjitha pleksën mjeshhtërisht në hapësirën e tij piktorale. Kjo hapësirë është e mbushur me ndjeshmërinë ekspresive si fill, një ekspresivitet, që sipas një logjike estetike, ngadalë nga faza në fazë, duke evoluar logjikshëm, arrin nga elementet figurative me një vizion figurativ realist-ekspresiv drejt një ekspresiviteti abstrakt, metaforik-simbolik për të mbërri në fazën e tij më të re në një shprehje figurative komplekse dhe kreativisht sintetike.

Kështu, duke pleksur në vete elemente të kërkuara postmoderne, që ka për pikëvrojtim modelues abstraksionin piktoral me elemente të theksuara simbolike, ai bëhet i kohës. Ky abstraksion i kërkuar dhe i arsyetuar artistikisht si evoluim, për të dëshmuar rrugëtimin dhe hulumtimin vetjak, tashmë ka arritur të krijojë një piktorë bashkëkohëse të trendit që sërish në vetvete pleks intencën e gjenezës kulturore, autoktone, për ta bërë të receptueshme edhe për ambientet tashmë të hapura kulturore, artistike dhe estetike evropiane dhe më gjerë.

Drejt ekspresionizmit abstrakt

Në fazën që kap vitet 1996-1998 piktori Shabani nxjerr në pah forcën dhe energjinë e tij ekspresive, ku krahas spontaniteti të kërkuar ekspresiv, i materializuar më ngjyra të përjetuara dhe të harmonizuara mbi bazën e kontrastit shprehës në të gjitha rastet edhe kur merret me pejsazhin edhe me figurën e njeriut, artistit me instrumentet me harqe, posaçërisht violonçelistin, që ka elemente të personalizuar identifikuese, por edhe të universalizuara njëherësh.

Ndër temat e realizuara nëpër faza të ndryshme është edhe kjo e artit të muzikës, përkatësisht me virtuosin në violonçel, që duket



se autori është shumë i mëshiruar dhe e realizon me një ndjeshmëri të veçantë sa në vërtetë i dëgjojmë edhe pasazhet e tëra të tingujve e melodive muzikore, përmes ritmit dhe tingëllimës së ngjyrave, që e bënë shprehjen e tij ekspresive vërtetë të përjetuar thellë estetikisht. Aty pranë e kemi edhe figurën e femrës që po ashtu na del një temë sa e gjerë po aq e thellë e hulumtuese. Paralelizmi: bota komplekse e femrës, bota muzikore dhe peizazhi posaçërisht ai i reminshencave të kujtimeve për detin janë tema të preferuara dhe të realizuara me nerve nivel estetik. Intenca që shprehjen piktorale ekspresive ta pasurojë e ta bëjë më sublime, me elementet poetike, pak a shumë surrealistike, ose me një nivel jo të skajshëm abstraksionizmi gjeometrik-kubistik i shquan punimet e krijuara brenda vjetëve vijues 1999-2000, (që na bënë të hetojmë e kujtojmë një ndikim të lehtë dhe kreativ nga Pikaso dhe Matisi).

Posaçërisht pejsazhi dhe akti i femrës i vendosur edhe në hapësira abstraksioniste, i realizuar me një frymë ekspresive, (gati në formë kroki), pa hyrë në detajizime e konkretizime të tepëra, po edhe me një surrealizëm i lehtë, më shumë në një hapësirë surrealistike simbolike, janë veprat që krijojnë brenda këtyre viteve. Mendojmë se është një angazhim i çmuar i këtij krijuesi, kur mëton më bindshëm të dëshmojë energjinë e tij kreative edhe në rastet e zhvillimit të cikleve në variante. Në piktorin "Koncert në Venedik", 1999, hasim një ekspresivitet dramatik ekspresiv dhe njëherësh lirik-poetik. Në këtë vazhdë na shfaqet një piktorë vërtet polifonike e autorit edhe në rastet kur merret më temën

NË FOTO:

Veprat e piktorit vlonjat Artan Shabani.



Artan Shabani (1969) një vlonjat i brezit të ri, i brezit të kthesave të mëdha shoqërore, që nxitën hapjen dramatike të Shqipërisë, përballë dhe brenda Evropës, me vendosjen e tij në Itali (Torino) 1991, pas një periudhe jo të gjatë, krijoi një hapësirë të veten krijuese, për të dëshmuar energjinë, kreativitetin dhe individualitetin, me botën e një shqiptari, që ka të pleksur në vete kualitete njerëzore, artistike dhe përgjithësisht kulturore, për të qenë kështu një përfaqësues vazhdimisht dëshmuar dhe premtues.

e vetmisë, nostalgjisë, apo obsesionin me botën po ashtu polifonike të femrës, që edhe të ky piktor, si të shumë të tjerë, del i veçantë nga ky ballafaqim krijues, duke arritur që ta bëjë një avancim të kërkimeve të tij drejt shprehjes më të abstraguar në aspektin figurativ, duke i dhënë shprehjes edhe dimensione me të universalizuara.

Ritmi ekspresiv është një veçanti e kësaj faze, por edhe një spektr i kërkuar koloristik, me të cilën fazë tregon një mjeshtri vërtet individuale edhe në materializimin estetik të temës, por edhe në pikëvrojtimin modë, duke e fokusuar në mënyrë të qartë objektin estetik përbrenda hapësirës piktorale. Kompozicioni nuk del i ngarkuar me shumë elemente, por në këtë rast flet më shumë ritmi, atmosfera të sajuar me ritmin e gjurmëve të penelit, që ka një polifoni të veçantë që më bëhet së ka për model arketip polifoninë labe të mishëruar në piktorë! Këtu në mënyrë aq të ndjeshme bashkëjetojnë piktura me muzikën sa befasia për të mirë shkon deri në mahnitje.

Pikturë abstrakte-rationale e çështjeve dhe ideve

Nëse e përshkojmë vijën evolutive të këtij krijuesi vërtet të talentuar nga natyra dhe të kultivuar me një pasion të veçantë, shohim se atë e preokupon çështja e mos përsëritjes së vetvetes, hulumtimi i shtresave të paprovuara për të, të botës së artit pamor. Kjo intencë na shfaqet bind-

shëm gjatë viteve 2000-2002, kur ky autor provon me ngulm thjeshtëzimin e shprehjes, duke bërë një thjeshtëzim (abstrahim) të mëtejshëm të figurës në hapësirën kompozicionale, edhe ngjyra bëhet më e racionalizuar dhe më e ngarkuar me pikëpamje metaforike dhe simbolike, duke iu larguar atmosferës ritmike dramatike-ekspresive. Kjo piktorë më shumë na del e racionalizuar, ku emocioni ekspresiv nuk është në plan të parë, më shumë don të shtrijë çështje e ide që janë më universale, por prapë në këtë universalitet rrezatues ruhen lidhjet me etnogjenezën, që do të bëhet më kërkuese në modelimin krijues në fazën që përshkohet brenda viteve 2003 e tutje 2005-2006, kur na del përpara me një eksperimentim interesant, ku më shumë flet simboli dhe metaforika abstrakte, që korrespondon, apo do të themi është në një rezonancë e aktualitetit krijues bashkëkohor! Kjo shprehje e ka dhembjet e veta dhe për mendimin tim largimi nga një ritëm piktoral dhe muzikor më duket se tregon për një obsesion të krijuesit që të rreket me trendin, por të mos veprojë në dem të sublimes piktorave (!).

Ndoshta pse tashmë jemi në një fazë të re, ngase krijuesi prore është në një ta quajmë mohim dialektik të vetvetes për të krijuar risi, për të përtërirë individualitetin krijues! Sido që të jetë, ka kontinuitet në këtë kapërcim, dhe piktura e Shabanit tani pasurohet me një polifoni simbolike



shumështresore të nëntekstit piktoral. Nëse është tëhuajuar nga ritmi, atmosfera koliristike kontrastive më dinamike, ajo në këtë fazë është pasuruar me nëntekstin abstrakt simbolik që sërish në brendi e ruan qenien shqiptare, etnikumin e begatë historik, kulturor, etnografik, etnomuzikologjik, etnopsikologjik etj.

Një tregues për të parë këtë intencë janë sidomos variacionet e autortreteve të tij, por edhe futjen e figurës personale me elemente tipike reale edhe nëpër piktorat e tjera, identifikimi me figurën me kostume kombëtare të jugut të Shqipërisë, pastaj portretet me çelshen karakteristike, si shenje dalluese etnopsikologjike, por posa-çërisht loja e skajshme ekspresive me gjurmët e lojës deri në spontanitet afektiv të shndërruar në një simbol, që do ta quaja shpirtin krijues të autorit, që kapet në kaosin e dinamiken e saj, prej nga buron shpirti kreativ, tregojnë në një mënyrë për mëtimin që është preokupim me ngarkesa të mëdha psikologjike krijuese, se ky autor këmbëngul të bëjë një transformim, në këtë rast krijues, që na shfaqet ne veprat e vitit 2005 dhe këto më të rejt në vitin që po hyjmë. Sipas këtij ritmi duket se tashmë jemi në një fazë tipike të re ku shprehja bëhet më abstrakte dhe më universale në formën e saj për të trajtuar disa dimensione më filozofike të jetës, historisë dhe artit. Hë për hë ajo është në konsolidim e sipër dhe besojmë se si

edhe në fazën më tipike ekspresive, ku flasin penelat me ritmin e gjurmëve dhe ngjyrës pastoze me kontraste që tregojnë për një psikologji dramatike që ka identifikuesit e saj në botën e artit modern, por në rastin e Shabanit ajo ka veçantitë e tij dhe do të mbetet pjesa më inspirative e punës së tij në botën e artit të piktorës. Operimi dhe loja kompozicionale dhe ideore me figura gjeometrike mëton të bartë disa mesazhe në kontekstin kompozicional me figurën e njeriut tipik etnopsikologjik dhe etnografik shqiptar që shfaqet edhe me një nostalgji kohore, por edhe me një porosi shenjzuese identifikuese aktuale socio-kulturore në kontekstin e kohës konkrete dhe universale njëherësh. Do të thoshim se të thjeshtëzuar në kolorit, pra të lehta edhe në formë, ato bëhen më me peshë me nëntekstin metaforik-simbolik, për të mos thënë përmbajtje, sepse ajo nuk është shumë e definuar, për të mos e bërë piktorin transparent deri në deklarativizëm ilustrativ.

Veprat si "Via Egnatia", "Resurset humane" janë tipike për këtë formë shprehjeje. Dikur kolorit që mbështetet në kontaktet e kërkuara dhe të baraspeshuara me një ndjenjë subtile estetike, si e kuqja, e kaltra, e verdha, okeri e nuançimet mbi këtë bazë ngjyrash, tani thjeshtëzohen dhe bëhen gati monokromatike, apo me një spektër të kufizuar ngjyrash, që neutralizohen me të bardhën në të hirtë, që i jep dimension meditacionit dhe abstraksionit. Tani figurat janë simbole në vetvete (labi, shkallët, rruga, karrija etj. shtrihen nëpër koordinata hapësirore dhe kohore), dhe të rikuptimsuara në kontekstin piktoral-kompozicional. Ndërsa më parë ngjyrat kishin forcën e ekspresionit brenda figuracionit dhe të pleksura në një rezonancë ekspresive shumëzërëshe, tani ngjyra në natyrën e saj brenda piktorës është simbol. Këtu tingëllojnë habitshëm në kujtesën time receptuese violonçelisti në disa variane pikturave që janë ndër piktorat vërtetë të realizuara me mjeshtri. Me të në mënyrë simbolike si edhe në autoportretet me lojën e lëvizjes së lirë të penelit në dorë Artan Shabani shpalos kredon e tij, dashurinë sublime ndaj artit, krijimit që na fisnikëron... dhe premtimit për vazhdimësinë e rinuar!...

Nga Engjell Fino

Martesa, një ndër evenimentet më të bukura të jetës, ka rituale dhe zakone të veçanta në Shqipëri, duke iu përshtatur karakterit të çdo krahine. Qyteti i Gjirokastrës, ka zakone shumë të bukura të zhvillimit të kësaj ceremonie. Në periudhën para çlirim-it, të gjitha martesat bëheshin me mblesëri. Zakonet dhe dasma gjirokastrite kishin traditë të veçantë. Në krijimin e çifteve të reja, tradita ishte që vajza kërkonte djalin. Pasi pikasej nga ana e vajzës, djali e familja e tij, kur do të jepej vajza, prindërit e saj çonin krushqarin (lajmësin) te familja e djalit. Shpesh fejesat bëheshin nga kryetarët e familjes dhe në kafenetë e qytetit. Kuputohej në të dy rastet nuk merrej fare parasysh mendimi i vajzës apo i djalit. Ata e merrnin vesh kur bëhej fakt i kryer. Një zakon tjetër (jo i përhapur shumë) në Gjirokastrë, ka qënë edhe martesës midis vajzës me djalin e tezes. Kjo bëhej për të qënë përjetësisht e pashkëputur kur vajza ishte jetime, po edhe për shkaqe si: për t'ju shmangur shërbimit ushtarak të kohës, për shkaqe prone e ekonomike, për përshpitje, etj. Disa nga momentet e ceremonive.

Dhënia e duarve

Lajmësi, pasi merrte pëlqimin e të dy palëve për lidhje martese, bisedonte me të dy familjet e caktonte ditën, kur do të jepeshin duart për t'u bërë kështu faktike lidhja e dy të rinjve. Përfaqësues nga të dy familjet, vetëm burra, babai, xhaxhai dhe dajot, caktonin një nga kafenetë e pazarit për ta takuar. Ata i jepnin dorën njëri-tjetrit e uronin: "Të na trashëgohehen e me jetë të gjatë". Pas këtij urimi, hahej llokumja pastaj siç ta vendosnin, pinin për disa orë raki, shpesh biseda shoqërohej me këngë karakteristike gjirokastrite.

Ndrrimi i Nishanit (Fejesa)

Pasi përfundonte dhënia e duarve, krushqari dhe pjesa tjetër e familjeve përhapnin lajmin e fejesës. Që nga kjo kohë, vajza nuk dilte më nga shtëpia. Quhej e zënë dhe niste përgatitjen e pajës. Çifti nuk kishte të drejtë të takohej deri në ditën e martesës.

Pasi kalonin disa javë apo muaj, vendosej dita e ndrrimit të nishanit. Ditët duhet të ishin e enjte ose e diel asnjë ditë tjetër. Fejesa bëhej në shtëpinë e nuses. Në ditën e caktuar vinin nga ana e dhëndrit, 11, 15, 17, 19, apo 21 vetë (krushq). Me ta vinte edhe dhëndri, por jo vjehrra (nëna e dhëndrit). Dy më të moshuarit, babai i djalit dhe i vajzës zinin vend në krye të odës. Përshëndeteshin, vinte nusja me kupol me gliko (ëmbëlsirë karakteristike e Gjirokastrës) me një gotë me lugë kafeje e me një gotë me ujë. Qerasja niste nga më të moshuarit. Secili nirrte lugën, e mbushte me gliko nga kupa e pasi uronte "Të na trashëgohehen" e hante dhe lugën e vinte në gotën me ujë. Pas glikosë, vinin me radhë: llokumet, karamelet, bombonet, amaretat,



Pamje nga ritualet e dasmës gjirokastrite. Foto e viteve '78.

Dasma gjirokastrite

Ritualit i dasmës gjirokastrite, momentet kulmore, kënga polifonike dhe sa është ruajtur në ditët tona

rakia (për burrat) e lloj lloj ëmbëlsirash. Në mes të qerasjes bëhej ndrrimi i nishanit. Të dy të moshuarit, i jepnin njëri tjetrit shenjën e fejesës (unazën e byzylit). Ato ishin të vendosura në kuti të bukura, të mbështjella me shami mëndafshi, të bardha e të kuqe. Nusja qërastej nga krushqit me lekë që hidheshin në tavolinë gjatë kohës së zhvillimit të kësaj ceremonie, nuk mungonin shakatë e namuzet, por shumë të kufizuara e me lezet.

Ajo që ishte e veçantë dhe që ngjallte humor në këtë ceremoni ishte momenti i largimit të njerëzve të dhëndrit. Sipas zakonit, për tu treguar të zgjuar e më të "lartë" se njerëzit e nuses, shumë prej tyre ata më të "shkathëtit" merrnin me lezet, pa u diktuar, pirunë të pastave, lugë të glikosë, gota rakie, çentro, mbulesa jastëkësh, etj. Më e bukura ishte se këto sende i nxirrnin të gjithë ata që i kishin marrë në oborr. Të gjithë shokoheshin nga ky veprim gazmor e gajaseshin së qeshuri. Ky qe një lloj "ofendim" për shtëpinë e nuses dhe një "krekosje" për njerëzit e dhëndrit. Pasi vinte momenti i takimit, fëmijës së vogël që sillnin për mbarësi krushqit, nëna e nuses dhe njerëzit e saj i jepnin një bohça të bukur me ëmbëlsira të gjithëllojshme. Duhet theksuar se së bashku me unazën e fejesës, ana e dhëndrit çonte në ditën e ndrrimit të nishanit edhe peshqeshe të tjera të nuses si këpucë, shami koke e duarsh, parfume, çorape, copë për fustan, stofë për kostum, etj.

Nata e brumit dhe dita e kënasë!

Nga dita e fejesës, kalonin 2-3 muaj dhe caktohet data e martesës. Sa hynte java e dasmës, të dy palët bënin përgatitje që ajo të dilte sa më mirë e të linte mbresa tek pjesëmarrësit e sidomos në lagje. Ditën e enjte, tre ditë para të dielës që ishte data e dasmës

në shtëpinë e dhëndrit e të nuses, ishte nata e zënies së brumit për gatimin e byrekëve e bakllavasë e që quhej "Nata e brumit". Për të dy palët kjo qe nisja e dasmës. Që nga e enjta e deri të dielën nuk pushonte kënga e gazet. Për gatimin e brumit dhe hullimit të petëve për byrek e bakllava, thirreshin gra të moshës mesatare nga fisi, dhe dy tre gra nga gjitonët, të moshuara. Në miellin që hidhej në magje ku do të gatuhej brumi, hidhej një monedhë metalike për nxjerrjen e së cilës, vihej djali më i vogël i shtëpisë i cili fuste kokën në miell dhe nxirrte monedhën me dhëmbë. Tërë dhoma ku do të holloheshin petët, në këtë moment shpërthente në të qeshura e pas tyre ushtonte kënga e mirënjohur: "Sonte që zëmë brumë...". Puna niste që në mbasditë e vijonte deri në orët e parë të ditës së premtë, në të shumtën e rasteve deri në mëngjes.

Në këtë ditë po në shtëpinë e vajzës bëhej dhe ngjyrosja e flokëve me këna dhe nisja e nuses, Vajza nisej nuse me rrobat e nusërisë. Vishej fillimisht me kostum popullor, çitjane, këmishë, jelek, brez, këpucë të qëndisura me kadife, feste me qëndisje ari e argjendi me xhufka anash me dhambro e me tirtir.

Të bëheshin zbukurimet e fytyrës me sqafidh e kaqinadh (me të kuq e me makiazhe të kokës). Niste periudha e nusërimit që zgjaste deri sa mbaronte dasma të hënën në mëngjes.

Që nga e enjta deri të dielën, vajza mbante disa kostume nusërie, duke përfunduar te ai që do të nisej tek burri. Me kostumin tradicional të nuses në Gjirokastrë, përveç pjesëve përbërëse të mësipërme, ishte edhe duvaku që këtu në Gjirokastrë quhej edhe çatore. Të gjithë pajën, nusja e bënte vetë. Në pajë hynin kostumi i nusërisë, jastëkë, jorganë, çarçafë, çentro të ndryshme, këpucë, parfume, peshqirë, peceta buke, etj. Por sa më e

madhe e cilësore të ishte, aq fisnikëri tregohej për nusen. Ajo çohet te dhëndri në mëngjesin e ditës së dasmës me tre- katër gra dhe sepeti çohet më një hamall.

Dita e dasmës

Ceremonia e dasmës, në të dy familjet niste ditën e shtunë. Te familja e nuses bëhej darka ceremoniale ndërsa te familja e djalit mbledheshin të afërmit ose të ftuarit e largët e bëhej një darkë modeste. Në darkën ceremoniale të së shtunës që bënte familja e nuses, shkonin edhe një grup krushqish nga ana e burrit (dhëndrit) të cilët rrinin një deri në dy orë. Ky grup i përbërë nga burra e gra venin kryesisht xhaxhai, dajua, halla, vëlla, motra dhe ndonjë mik apo fqinj. Gjatë gjithë ditës së shtunë (ose të mërkurë) kur nusja mirrej të enjten në shtëpinë e dhëndrit të ftuarit binin peshqeshet. Peshqeshi më i preferuar ishte mishi. Mishi i therur zbukurohej me lloj lloj lulesh e letra me ngjyra me fjongo, tantella, etj. Ditën e dasmës së dhëndrit të dielën ose të enjten në mëngjes ceremonia vijonte me ritin e të marit të dhëndrit. Vinte berberi i porositur e dhëndri vendosej në një karrige në oborr ose në një divan të shtëpisë të rrethuar nga dasmorë plot humor. Gjatë rojes, këndohej: "Berberi që nga Stambolli e mira këtu ç'e solli"

Gjatë gjithë mëngjesit të së dielës bëheshin përgatitjet e ditës së dasmës. Në drekë përgatitej grupi i krushqve që do të marrin nusen. Në qytet brenda ky grup duhej të ishte sa më i madh, ku përfshiheshin në të këngëtare gra e burra të njohur. Grupi i krushqve përshkonte në këmbë rrugën deri te shtëpia e nuses duke kënduar. Sa mbërrinin afër shtëpisë së nuses vinte kënga e njohur: "Pritna...x... krushk pritna/se vjen dhëndri me trima"

Njerëzit e nuses e prisnin me këngë në oborr. Niste kështu atmosfera gazmore e këngëve aq

të njohura gjirokastrite hidh e prit! Pastaj, njerëzit e afërt të dhëndrit e ky bashkë me ata të tjerët prisnin në dhomën e pritjes ku qeraseshin sipas zakonit.

Pasi këndonin 3-4 këngë, çoheshin për të marrë nusen. Gjëmtonte kënga karakteristike gjirokastrite "Ç'ka sokaku që gjëmon/dhëndëri me nusen shkojn...". Në ball të krushqve, përpara nuses ishte një djalë veshur bukur, i moshës 5-8 vjeç që mbante në dorë një lugë të futur në një copë buke që në shprehjet e Gjirokastrës ka hyrë "bukë e lugë". Kjo e ka domethënien e saj që atje ku vetë nusja të ketë bollëk e jetë të gëzuar. Krushqit që shoqëronin nusen, nuk e kalonin nga rruga që përshkuan kur erdhën për ta marrë, por nga një rrugë tjetër çka tregon se kjo shërben për t'i trashëguar.

Bëhej kujdes i madh që të mos ndodhte që në një kalim të tillë të takoheshin në një rrugë dy nuse. Kjo quhej fatkeqësi e madhe dhe ndjell përfundime jo të mira në jetën e çiftit të ri. Në kohët para viteve 1930, nusja edhe në Gjirokastrë merrej me duvak për të mos parë fytyrën të tjerët se ishte shumë turp. Para se të kapërcente praguan e derës, lyente harkun e saj me mjaltë me qëllim që të kalonte një jetë të ëmbël. Pasi e puthte në ballë vjehri e vjehra, nusja vendosej në dhomën e saj.

Takimi i nuses me dhëndrin

Këtu kemi momentin më interesant të dasmës që quhej "futja në gjerdhek"! Takohej vetëm për herë të parë nusja me dhëndrin. Jashtë derës të dhomës të ndarë në dy grupe, majtas e djathtas, me një korridor në mes rrinin 10-15 djem, nga fisi i dhëndrit. Ai pasi i hiqte nuses duvakun e shikonte në fytyrë dhe mund t'i thoshte dhe ndonjë fjalë. Djemtë që e prisnin përjashta e shoqëronin ecjen e tij me grushta e shkopinj duke qeshur me të madhe. Pastaj, nusja vendosej në dhomën e grave. Pranë saj qëndronte një grua me të cilën nusja komunikonte për çdo nevojë që kishte. Ishte krejtësisht e ndaluar të fliste apo të bënte ndonjë lëvizje të tepruar. Nusëronte natën e dasmës në këmbë. Sa hynte në dhomë vjehra ose ndonjë nga gratë e vajzat e shtëpisë së dhëndrit, nusja po ishte ulur, ngrihej menjëherë në këmbë. Këtë veprim e bënte edhe kur hynte në dhomë edhe fëmija më i vogël i shtëpisë. Një nga evenimentet në trapezet e burrave, ishte vallja në sini. Një deri në dy vetë kërcenin këtë valle që e kishte karakteristike vetëm Gjirokastra (qyteti) njëri i veshur me fustanellë kërcente vallen në mes të sinisë, tjetri ia mbante jashtë saj. Sinia ishte plot me pjata me meze e me gota rakie. Bukuria e zotësia e atij që hidhte këtë valle të hijshme e tepër interesante ishte që gjatë lëvizjes të mos prekte asnjë gotë apo pjatë. Në darkën e dhëndrit, venin edhe grup krushqish nga nusja, numër tek, jo më pak se ç'shkonin nga dhëndri një natë më parë tek darka e nuses, të shtunën.

Arjan Shehu, këngëtari me zërin instrument

Profil i solistit të grupit "Ergjëria" përfaqësuesi më i denjë i Iso-Polifonisë gjirokastrite

Emrin e ka Arjan, por të gjithë i thonë "birbil". Eshhtë ngjitur në skenë kur ishte 12 vjeç dhe ka marrë pjesë në 6 festivale folklorike ndonjë është vetëm 45 vjeç. Djali i një Dervishi Halvetian që njihet në Gjirokastrë si Sheh Tata Jonuzi i Dunavatit. Në familjen e tyre nuk ka njeri që të mos dijë të këndojë këngë lapçe. Arjani ka shkuar për të prezantuar polifoninë e tij në plot 11 vende të Europës.

Sa herë që Arjani ngjitet në skenë të gjithë mbajnë frymën. Të gjithë e cilësojnë një solist të paarrtshëm, unik, me një zë të rrallë, të ëmbël, plot tonalitet, përfaqësuesi më i denjë aktual i iso-polifonisë së Gjirokastrës. Janë të shumta këngët e interpretuara nga grupi i të rinjve të qytetit që kanë hyrë në fondin e artë të iso-polifonisë. Arjani nuk ka shumë fjalë, nuk flet gjatë, por të gjitha i thotë me këngë. "Kur nis të këndo, më këndon zemra e shpirti. E kam trashëguar në breza këtë traditë dhe jam i lumtur që kënga polifonike vazhdon të pëlqehet edhe nga brezat e rinj".

Gjatë interpretimeve



Në foto: Arjan Shehu (i treti nga e majta) së bashku me grupin polifonik "Ergjëria".

të tij në festivale apo aktivitete të tjera, këngët e tij kanë lënë mbresë për tekstin e goditur, mjeshhtërinë e interpretimit dhe melodinë me të cilën përcilen tek publiku. Në interpretimin më të fundit në festivalin e veglave të muzikës popullore ai ngjitet në skenë kur atmosfera lirike baritore, ia lë vendin logatjes epike të këtij korifeu të madh të polifonisë qytetare gjirokastrite. "Çu bë Dunavati sterë". Zëri si rrjedhë e kristaltë

uji i Arjan Shehut në interpretimin e kësaj logatjeje që ekspertët e folklorit e quanë në gjuhën e tyre shkencore "mono dy", natyrisht shoqëruar edhe nga tingujt e zileve të picariotit Xhevahir Guçe, imponuan një heshtje në radhet e spektaktorëve, sa që në atë çast u duk sikur edhe kalaja mbajti frymën. Motivet e logatjes së Arjanit na kujtuan monofoninë e të madhit të Iso-Polifonisë gjirokastrite, artistin e shquar Xhevat Avdalli në

interpretimin e kolonës zanore të filmit "Liri a vdekje". Nuk ishte vetëm tingulli i zileve të Xhevahir Guçes që e përfshinte këngën "Çu bë Dunavati sterë" brenda kritereve të festivalit të veglave muzikor, por ishte vetë zëri i Arjanit, ngjyrimet, tingujt e prodhuar nga gryka e tij, loja "vetë hidh" dhe "vetë prit" e logatjes, pa më të voglin dyshim i dhanë pamjen e një instrumenti të vërtetë muzikor.

G.Brahimi

Polifonia si gjini kryesore muzikore e muzikës polifonike vokale në Toskëri dhe Labëri.


Kënga polifonike dhe një poezi nga Lasgush Poradeci

Kënga polifonike është gjinia dhe forma kryesore muzikore e muzikës polifonike vokale në Toskëri dhe Labëri. Enci. Në rast se në Toskëri kemi vetëm këngë polifonike dy zërëshe dhe tre zërëshe, polifonia labe ekziston në tre lloje kryesore: polifoni me dy zëra ose dyzërëshe, polifoni me tre zëra ose trezërëshe, polifoni me katër zëra ose katërzërëshe. Në këtë vështrim, polifonia jonë duket se e ka zgjidhur drejt sa unitetin e zërave e po aq diversitetin, pa të cilin është shumë e vështirë të krijohen zëra të individualizuar. Tek Lasgush Poradeci gjejmë përshkrimin letrar të një kënge polifonike në rapsodinë poetike "Bjenë telat":

*Dh'atëhere... nënë mal...
Nisi kënga me -nga-dal...;
Nisi këng' e shënjtëruar,
E ja mori me të shtruar...;
E ja drodhi me të qarë...
E ja zjeu... ja hoqi zvarrë...;
E pastaj si më s'u ndje,
Zu të ngrihet që përdhe
Gjith më nge... e gjith më nge...;
E pastaj filloi të rritet...
E të ngjitet... e të ngjitet...
Më me sulm... e më me jetë...
Më përpjetë... e më përpjetë...
Dhe' aq dëshirë- e aqë gas,
Aqë mall lëshovi pas,
Aq me zë të parpalitur
Pat kënduar dyke ngjitur,
Sa... që lart kur fluturoj,
Heshti pak edhe rënkoj
Dh'u këput posi përroj...
Pa prej kulmit qielluar
Ra përposh me t'ulëruar,
Posi breshër i thërrmuar...
Posi lot i përvëluar...*

Lit: Shitumi S, "Polifonia labe", Tiranë 1991; Kruata B "Polifonia dy zërëshe e Shqipërisë Jugore", Tiranë 1991; Çausi Tefik, "Fjalor i estetikës", Tiranë 1998; Tole Vasil S. "Folklori muzikor-polifonia shqiptare", SHBLU 1999 etj.

Promovohet në Gjirokastrë "Odiseja dhe sirenat"



Në kuadër të veprimtarive të organizuara gjatë ditëve të Festivalit Kombëtar të Veglave të Muzikës Popullore dje në orën 10 në sallën e hotel "Çajupit" u bë promovimi i librit "Odiseja dhe sirenat" shkruar nga

prof.dr.Vasil. S. Tole. Ky libër bën lidhjen e këngës së Sirenavë me muzikën tonë iso-polifonike. Me argumentat e shtjellur në vepër dhe përmes faktit që evidentohet në të, autori tregon se sa e vjetër dhe e hershme është tradita e të kënduarit të polifonisë me Iso në trojet shqiptare. Libri gjithashtu ka zënë një pjesë të rëndësishme të dokumentacionit të përfshirë në dosjen e UNESCO-s, duke bërë të mundur marrjen e iso-polifonisë nën mbrojtjen e saj. Gjatë diskutimeve nga të pranishmit libri u vlerësua maksimalisht për vlerat e tij shkencore.

Ndër diskutantët spikati fjala e prof.dr. Afërdita Onuzit e cila ishte edhe në cilësinë e moderators së këtij diskutimi. Onuzi pasi foli për aktivitetin dhe punën e Z.Tole mës të tjerash tha "Vaso tole nuk mund të shihet absolutisht si një burokrat i zyrave, por si një studiues i mirëfilltë i folklorit muzikor shqiptar". Gjithashtu libri mori vlerësimet më të mira nga prof.dr Josif Minga si dhe nga intelektual i gjirokastrit Thanas Dino. Por për autorin e librit Vasil Tole, kjo ishte vetëm njera pjesë e kënaqësisë. Në këtë takim promovues të librit të tij ai u nderua me titullin e lartë "Nderi i Qarkut". Titullin ia dorëzoi kryetari i këshillit të qarkut të Gjirokastrës Resul Llogo me motivacion për vlerat dhe kontributin e tij personal për futjen e Iso Polifonisë në mbrojtjen e UNESCO-s. Takimi përcolli një larmi temash e diskutimesh të cilat u përqëndruan në vlerat e jashtëzakonshme të Iso-Polifonisë shqiptare.

Eduart Nurka
Specialist pranë Qendrës së Organizimit të Veprimtarive Folklorike, Tiranë

Promovohet libri "Në thesaret e kulturës lunxhiote"

"Në thesarat e kulturës lunxhiote", libri i muzikologut të njohur gjirokastrit Naxhi Kasoruh, u promovua dje në ambientet e hotel "Çajupit". Studiues, shkrimtarë, poetë e mjaft të ftuar kanë diskutuar për librin që hedh dritë mbi kulturën dhe folklorin e zonës së Lunxhërisë. Promovimi i këtij libri u bë i mundur nga këshilli i qarkut të Gjirokastrës dhe shoqata kulturore atdhetare Lunxhëria. Takimin e ka çelur prof.asc.dr. Resul Llogo që ka vlerësuar librin e Kasoruhos për matrialet dhe gjerësinë e studimit të folklorit të kësaj zone. Apostol Duka sekretar i përgjithshëm i shoqatës ka falënderuar autorin në emër të kësaj shoqate. Vlerësime dhe opinione pozitive kanë dhënë edhe drejtorja e Institutit të Kulturës Popullore Afërdita Onuzi, prof.dr. Agron Xhagolli, Petrit Llano, Thanas Dino, Osman Buzo. Më pas shumë nga të pranishmit kanë diskutuar për librin, këngët dhe matrialet që janë përmbledhur në të, si dhe për punën e madhe të muzikologut.

Nderim korifejve të këngës polifonike gjirokastrite

Labëria, Lunxhëria, Zagoria dhe Gjirokastra homazh për polifoninë dhe protagonistët e saj në vite

Një homazh për polifoninë e trevës së Gjirokastrës dhe emrat që e ruajtën dhe kultivuan atë në vite. Ky ishte aktiviteti që ka mbledhur bashkë këngëtarë popullorë, artistë, poetë, e banorë të zonave përreth. Nisma për të organizuar një veprimtari të tillë ka ardhur nga disa shoqata kulturore atdhetare që e kanë pjesë të pandarë të kulturës së tyre Iso Polifoninë. Në sallën e kinoteatrit "Zihni Sako" bashkia e qytetit dhe shoqatat kulturore atdhetare "Labëria", "Lunxhëria" e "Zagoria" festuan hyrjen e Iso Polifonisë si pjesë e Trashëgimisë Kulturore Botërore.

Të pranishmit në aktivitet nuk kanë lënë pa përmendur edhe kontributin e disa prej këngëtarëve më të njohur që i dhanë peshë e lartësuan këtë pasuri duke e bërë pjesë të vlerave më të mira të folklorit në vend. Kryetari i bashkisë Flamur Bime në fjalën e tij është shprehur se "ky aktivitet tregon më së miri vëmendjen, dashurinë dhe përkujdesjen e të gjithë për këngën popullore që është shprehësja më e mirë e momenteve kulmore të jetës. Kënga polifonike i ka shoqëruar banorët e Lunxhërisë, Zagorisë e Labërisë në hidhërimet e gëzime, në festa e fatkeqësi. Ajo është bërë pjesë e pandarë e historisë sonë, duke përjetësuar ngjarje, heronj e dëshmorë të ardhur nga shekujt e ata të ditëve të sotme". Bime ka falenderuar të gjithë pjesëmarrësit për praninë e tyre në këtë veprimtari dhe ka përmendur disa prej emrave më të njohur të këngëtarëve të Iso Polifonisë.

Fjalën në takim e kanë marrë edhe përfaqësues të shoqatave kulturore Lunxhëria, Zagoria e Labëria.



Ata janë ndalur tek karakteristikat e veçanta të kësaj këngë në këto zona dhe tek interpretuesit më të mirë të saj. Të pranishmit kanë vlerësuar faktin se megjithë ndryshimet ekonomike, sociale dhe shoqërore kënga polifonike po përcillet tek brezat e rinj. Por ata kanë kërkuar më shumë vëmendje për të ruajtur dhe mbrojtur disa prej vlerave të rrezikuara si kostumet e veshjeve, valle dhe këngë të vjetra që po zëvendësohen këto kohë me motive të reja. Aktiviteti "Nderim polifonisë gjirokastrite dhe protagonistëve të saj në vite", vjen pas një sërë veprimtarish dhe aktiviteteve kulturore të organizuara edhe në rrethe të tjera të vendit kushtuar Iso Polifonisë.

PROMOVIMI

Një libër për "gjeneralin" e klarinetës...

Në 77 vjetorin e lindjes të Laver Bariut vjen monografia e autorit Thanas Dino

Nga Engjëll Serjani

Pavarësisht se në historinë muzikore të sazeve tradicionale të Përmetit ka patur edhe shumë instrumentistë të tjerë me emër dhe talent të madh, emri i klarinetistit virtuoz Laver Bariu, për shkak të vazhdimësisë dhe shkëlqimit të talentit dhe artit të tij interpretativ në "kohët moderne", me mundësi të mëdha publikimi dhe përhapjeje, Usta Laveri do të mbetet emri dhe figura simbol i sazave përmetare. Në kuadrin e 77 vjetorit të lindjes, së tij dje u promovua në qytetin e Përmetit botimi i një libri monografik kushtuar këtij klarinetisti virtuoz që ka për autor shkrimtarin dhe publicistin vendas Thanas Dino. Të pranishmit në këtë promovim, kryesisht artistë, interpretues të traditës muzikore vendas dhe intelektualë të Përmetit dhe të qyteteve të tjera të rajonit jugor, vlerësuan lart figurën e instrumentistit të shquar dhe veçnisht stilin e veçantë narativ të autorit Thanas Dino në skicimin me vërtetësi të profilit të njeriut "me problemor" në marrdhëniet e tij me njerzit e letrave dhe mediave.



Shumë prej diskutantëve si Trifon Dafa, Kastriot Bezati, Arçile Naqellari, Lumo Kolleshi, Pëllumb Pacani, Natasha Karafilii, Përparim Islami, Albert Kasi, Peç Sevo, Aleks Todhe, etj, vlerësuan në këtë libër jo vetëm iniciativën e autorit për të skicuar portretin e Artistit të Merituar Laver Bariu, por afësisht dhe mjeshtërinë e autorit për të depërtuar në brendësi të shpirtit të tij delikat dhe human. "Ju me këtë libër nuk keni nderuar vetëm Laver Bariun, por të gjithë artistët dhe artin e bukur të popullit të Përmetit, i cili do të transmetohet nga ne tek brezat që vijnë", iu drejtuar të pranishmit autorit Thanas Dino.

Si e përcolli Usta Laveri promovimin e librit që mban emrin e tij?

Ustai ri e dëgjon ç'thonë për të. Mbyll pak sytë e kaltër


tur mirë në mëngjes.

Një nga folsi pasi e lëvdon dhe e lëvdon, i thotë: - Usta nuk ke vërë shumë që të na lëshë një tjetër Laver në Përmet,

-Javash, Unë i mësova jo një po ca që haram e paçn. Po unë ku mësova? Vetë mesova, se babain nuk e kisha me gërmetë, llahutën kishte ai, gërmetën e mora nga Vangjelli. Një vit pas tij. Nuku mësohet ashtu fët-fët. Pastaj përsëri hesht përsëri, për të shpërthyer më pas ndaj kameramanëve dhe fotografëve që i afrohen për ta filmuar dhe fotografuar.

-Gjene ju me mua. Ikni mos më mërzitni se sot jam bërë i bukur me nja dy teke, e kam kaluar shpejt merselenë. Ç'tu thom, gëzime në shtëpitë tuaja. Ashu më paç uratën.

Themeluesi dhe njëkohësisht drejtuesi i sazave të Përmetit, të njohura në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj, jeton sot në qytetin e tij të lindjes. Fle me gërnet tek koka. Mandej pak kohë më parë përcolli me klarinetë për në atë botë një mbesën e tij që u nda nga jeta parakohe. Një kor klarinetash e shoqëruan trupin nga shtëpia në varreza.



Letër e bashkëpunëtorit të gazetës Timo Mëkuri drejtuar kryeredaktorit

O Zot na jep pak iso-polifoni për shpirtin!

Zoti Kryeredaktor!

Me siguri që ju prisni që t'ju dërgoj ndonjë shkrim tjetër për iso-polifoninë ose për ndonjë problem tjetër, por me keqardhje ju them se unë s'mund t'ju shkruaj. Jo se s'dua t'ju shkruaj më juve dhe lexuesit tuaj të kulturuar, por jam shumë i zënë me problemet e partive politike. Ose që të shprehem më qartë, ato e kanë zënë me mua.

Kur erdhën socialistët në pushtet, me grinë me të shara duke më quajtur demokrat, bile më hoqën menjëherë nga puna. Bëra si bëra, jetova. Madje gjeta dhe një punë, ku vërtet, s'më lanë rehat, por gjithsesi mbijetova. Erdhën demokratët dhe sikur s'kishin punë për të bërë, e nisën me mua. Më shanë në shtatë breza si socialist, i kuq e rozë e ku ta di unë dhe më hoqën dhe këta nga puna.

Ore, do ketë në Shqipëri ndonjë parti që të më quajë ashtu si jam në të vërtetë: shqiptar e bir shqiptari dhe të ulemi e të flasim shqip me njëri-tjetrin?

Unë personalisht s'dua të përzihem me partitë politike, se andej nga anët tona partitë i quajnë... (turp më vjen, por do ta them. Ti po deshe mbylli veshet) p.p.p. prostituta.

Unë s'dua që ndonjëri të më quajë mua biri i partisë, d.m.th biri i p.p.p.... e kuptoje vetë.

Unë dua qetësisht të merrem me poezi dhe iso-polifoni.

Nuk po të dërgoj shkrime se kam frikë se më lavdëron dhe kur të më lavdërosh do të dëgjojë ndonjë parti e anës apo e qendrës dhe të ndëshkon edhe ty si mua.

Por po të dërgoj një lutje drejtuar Zotit në qiell, një lutje të tillë, të shkëputur nga bibla. Ia drejtoi Zotit dikur dhe Faik Konica dhe Zogu hop e caktoi ambasador në Amerikë. Vetkuptohet që unë s'pretendoj të vete kaq larg. Unë në fshatin që s'më qasin kërkoj për nuse vajzën e priftit.

S'ke ç'i bën miku im, Shqipëria është fshati që s'e do profetin dhe poetin e vet.

Por gjithsesi është vendi im dhe unë e dua kështu si është.

Dhe për të e për popullin tim të ftoj dhe ty në lutjen time si vijon:

Ati ynë i madh që je në qiell. Ardhtë mbretëria jote! U bëftë vullneti yt!

Mbroji shqiptarët nga qeveritë shqiptare! Mbroji poetët nga çdo qeveri!

Bukën tonë të përditshme na jep o Zot, për trupin! Dhe për shpirtin pak iso-polifoni!

Amin!

Nga Timo Mëkuri
Sarandë, më 24 maj 2006



ISO-POLIFONIA

ENGLISH
PAGE 8

Consult of albanian music and the albanian section of CIOFF edition
Realize in collaboration with "Dita JUG" newspaper staff

In this number you will read:

From Estref Dobi

The capital of Polyphony Valona celebrate the announce of Iso Polyphony as Intangible Cultural Heritage.

From Gentiana Brahimi

It's finish the forth editions of folkloric national music festival in Gjirokastra

From Estref Dobi

Bujar Leskaj Tourism Culture Youth and Sports Ministry said that Polyphony and Folk will be the priority of this ministry.

From Engjell Fino

The ritual of Gjirokatra marriage, high moments, Polyphony songs in it and how that is conserve in our days.

From Sejmen Gjokoli


Polyphony the first lady in Albania culture

From Gentiana Brahimi

The profile of Arjan Shehu, one of the best singers of Gjirokastra Iso Polyphony.

Expressionism pictorial context of Polyphony

Artan Shabani a painter from Valona had create an Albania image with the colour of Iso Polyphony



Artan Shabani a painter of a new generation, which lives in Italy, had create his space in painting world with a character of Albania man. As a real artist, Artan Shabani, expand his talent and became a painter with strong mark off polyphony. In his picture we can see a complex reality which had came from his memory. In this way Shabani attest his origin and his genesis. With his artistic substratum he gives in a modern way the concept of Iso Polyphony. In his composition we find ethnic culture, ethnographic and artistic quality. All this elements are combines masterly in his picture area. This area is full of sensibility following aesthetics motives he had create a realist expressionism figurative vision. Working with all this elements finally Shabani find out a new concept which is presents and his composition.

Abstract expressionism

In 1996-1998 years Shabani shows up his strength and his dynamism in picture. His energy and his spontaneity is materializes with lot of colour in a landscape and in a man image, especially in e illustration of a instrumentalist artist. Some of the best themes are realized through differently phase. The author became part of his painting with a specially sensibility and we can see and we can hear sounds of the passage from music melody. We can fell and enjoy the complex world on the picture. Rhythm and colour spectrum accompany individualistic art focus clearly in materialism of the theme. In this case the author has not prefer a composition with a lot of elements but the main things is the rhythm. The atmosphere through the paint-brush rhythm gives us a specially Polyphony which became a model for Iso Polyphony but in this case in picture. So Artan Shabani shows that picture and music can coexist together as a part of each other.

1 Albanian Music Council from Albania wrote on Mar. 21st, 2006:

Dear Sir,

The Albanian Music Council, member of IMC/UNESCO and Albanian Section of CIOFF has now for the first time published monthly newsletter "ISO POLIFONIA" (nr. 1, January, 2006) with information on Albanian Folk Iso-Polyphony, "A masterpiece of the Oral and Intangible Heritage of Humanity", protected by Unesco. and mor information of albanian intangible heritage issues.

best regards, Albanian Music Council
www.vasiltole.com, www.isopolifonia.com

"UN'ALTRA ALBANIA.... L'ALBANIA E NOI. Spettacolo & incontro per saperne di più" il 25 marzo ad ALBA, iniziativa teatral-culturale a cura del gruppo SCUOLA SENZA FRONTIERE "UN'ALTRA ALBANIA ...L'ALBANIA E NOI.

Spettacolo & incontro per saperne di più"

Sabato 25 marzo, ad ALBA nella Sala Beppe Fenoglio (Cortile della Maddalena) il gruppo SCUOLA SENZA FRONTIERE - formato da insegnanti albesi dei vari ordini scolastici - in collaborazione con l'Ufficio della Pace albese e l'Azione Cattolica diocesana, con il patrocinio del Comune di Alba, presenterà a partire dalle ore 15.00 un'iniziativa teatral-culturale e formativa dal titolo "UN'ALTRA ALBANIA... L'ALBANIA E NOI. Spettacolo & incontro per saperne di più". I momenti salienti dell'incontro saranno uno spettacolo di parole, immagini e suoni frutto della collaborazione tra scrittori, musicisti e attori albanesi e italiani e l'intervento di educatori e insegnanti albanesi e italiani di scuole statali e private della città albanese di Fier.

Look through at the heritage world culture value in Albania

1-Butrint, a mediterranean city

The Mediterranean has seen the rise and fall of many great civilisations and empires over the past three millennia. Butrint lies at the heart of this world, and the city that you see today reflects this Mediterranean history.

Early occupants and the changing environment

18,000 years ago, the landscape around Butrint was very different from today. Sea levels were much lower, and Corfu was joined to the mainland. 9,000 years ago, the sea



rose, and the hills that you now see around you, like Xarra, Shendelli, Kalivo and Shen Dhimitri, became small islands. Since then, rivers and rain have

carried silt and clay from the mountains to the coast, and what was once sea has slowly become salt marsh, and later, dry land. The discovery of stone

tools on these former islands demonstrates that the area has been occupied since prehistoric times.

2. The Butrint region in the bronze and iron ages

From 1200 BC, the area around Butrint was inhabited by tribes who lived in hilltop settlements. These were often steep-sided and fortified, suggesting that the tribes frequently lived in a state of insecurity and conflict. Butrint itself seems to have started as one of these tribal settlements.